

NEWSLETTER

Prill

**“I Love My Business”,
2.000 Persona në Trajnimin
e Ermal Mamaqit,
Pjesëmarrëse dhe Albsig**

**Albsig Mbështet
Eventin e Veçantë të
Asamblesë së Përgjithshme
të Dhomës
Amerikane të Tregtisë**



PJESË E  KASTRATI GROUP

**Albsig,
me Treguesit Financiar
më të Mirë në Total
për Periudhën
Janar-Mars 2023**

**Sigurimi i Pronës, një
Mundësi për t'u Mbrojtur
nga të Papriturat**

**Vera po Fillon?!
Si të Blejmë Online
Sigurimin e Shëndetit
në Udhëtim në Albsig**

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



ALBSIG

PJESË E



KASTRATI GROUP



A man with a beard and a small bun, wearing a black long-sleeved shirt and black pants, is speaking on a stage. He is gesturing with his hands. In the background, a large, blurred audience is seated in a hall. The image is framed by a large red circle on the left and a red arrow pointing right on the right.

“1 Love My Business”, 2.000 Persona në Trajnimin e Ermal Mamaqit, Pjesëmarrëse dhe Albsig

Është paraqitur komplet ndryshe, këtë herë në fokus ka qenë biznesi. Ndryshe nga cikli i trajnimeve të mëparshme, duket se pjesëmarrja ka qenë shumë më e madhe. Këtë radhë Ermal Mamaqi e çoi fokusin e trajnimeve të tij tek biznesi dhe rritja në karrierë dhe kur bëhet fjalë për biznes, salla është tejmbushur. Thuhet se rreth 2.000 persona u bënë pjesë e këtij trajnimi 2-ditor në Pallatin e Kongreseve. “Jam shumë i lumtur që edhe në Shqipëri po hapet ‘loja’ e trajnimeve. Nuk ishte e lehtë të mbushje një sallë me 2 mijë e ca vende, për t’i bërë të paguajnë një biletë jo shumë të lirë”, u shpreh Mamaqi. Për të ndarë rrugëtimin dhe sukseset e tij, në eventin “1 Love My Business” i ftuar special ishte biznesmeni i njohur Samir Mane. Të sjellësh elemente unike në treg është një nga këshillat e tij për sipërmarrësit e rinj. “Nuk mund të kem shumë gjëra unike në një biznes, por mjaftohem që të ketë një gjë. Pse gjëja unike do të funksionojë, çfarë gjëje unike ka”, tha Mane. Pjesëmarrësit i përjetuan të gjitha emocionet që ofroi ky trajnim. Ajo çfarë përfitohet mbi të gjitha është motivimi dhe njohuria për të rritur veten profesionalisht. “Fuqia e këtyre trajnimeve funksionon. Nëse do të kesh diçka që nuk e ke, duhet të bëhesh dikush që nuk je dhe që të bëhesh dikush që nuk je, duhet të shkosh në vende që nuk ke qenë, si këto trajnimet e çmendura që njerëzit kërcejnë dhe hidhen, mendojnë, preken, qeshin dhe qajnë”, u shpreh Mamaqi. Pjesë e trajnimit 2-ditor që nisi të premten ishin grupmosha të ndryshme, njëkohësisht dhe nga biznese të ndryshme që kanë lënë gjurmë në zhvillimin e ekonomisë në vend. Në trajnim morën pjesë dhe pronar të bizneseve që treguan me detaje historikun e biznesit të tyre dhe dhanë mesazhe të rëndësishme për biznesin e ri.



“Fuqia e këtyre trajnimeve funksionon. Nëse do të kesh diçka që nuk e ke, duhet të bëhesh dikush që nuk je dhe që të bëhesh dikush që nuk je, duhet të shkosh në vende që nuk ke qenë, si këto trajnimet e çmendura që njerëzit kërcejnë dhe hidhen, mendojnë, preken, qeshin dhe qajnë.”

-Ermal Mamaqi



Albsig Mbështet Eventin e Veçantë të Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës Amerikane të Tregtisë



Albsig mbështet eventin e veçantë të Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës Amerikane të Tregtisë në Tiranë. Albsig është shoqëria e sigurimeve, e cila duket se është mbështetëse e flaktë e biznesit. Albsig nuk ka investuar vetëm me paketat e sigurimeve për biznesin, por ka qenë dhe mbështetës në eventet e krijuara nga ana e tyre. Albsig mori pjesë në eventin e Dhomës Amerikane të Tregtisë, e cila zbuloi se gjatë dy viteve të fundit investimet e SHBA-ve në vendin tonë ishin më shumë se dyfishuar, pa zbuluar detaje të tjera nga shifrat e publikuara. Në tërësi, investimet e huaja direkte nga kompanitë amerikane, ishin rritur me dy herë e gjysmë në dy vitet e fundit, në bazë të treguesit të Dhomës. Presidenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë, Enio Jaço në takimin e zhvilluar në Asamblenë e Dhomës Amerikane të Tregtisë, tha se dy vitet e fundit investimet amerikane në Shqipëri janë rritur me 250%. Ai tha se, Shqipëria duhet të ofrojë një mjedis tërheqës për të siguruar investitorë strategjikë! “Çështja sot është qëndrueshmëria, pra si t’i bëjmë këta investitorë të qëndrojnë për një afat të gjatë kohor. Për ta arritur këtë, ne kemi nevojë për një klimë konkurruese biznesi dhe investimesh. Faktorë të tillë si lehtësia e lejeve, niveli i korrupsionit, a kanë investitorët shanse për të hyrë në prokurimet publike, a janë stimujt e investimeve konkurruese, janë çështje reale që përcaktojnë klimën e investimeve. Ne duhet të ofrojmë një mjedis tërheqës për të siguruar investitorë strategjikë”, tha Presidenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë. Duke folur për investimet amerikane në Shqipëri, Presidenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë, Enio Jaço theksoi se, “Për vite, investimet ngecën në rreth 80 milionë dollarë, por gjatë dy viteve të fundit, investimet janë rritur në 220

milionë dollarë – një rritje e jashtëzakonshme prej 250%. Kjo tregon ndryshimin e realitetit, por ne duhet të pranojmë se jemi ende shumë nën potencialin tonë. Ne duhet të synojmë për miliarda investime. Çështja është qëndrueshmëria – si t'i bëjmë këta investitorë të qëndrojnë për një afat të gjatë kohor. Për ta arritur këtë, ne kemi nevojë për një klimë konkurruese biznesi dhe investimesh. Faktorë të tillë si lehtësia e lejeve, niveli i korrupsionit, a kanë investitorët shanse për të hyrë në prokurimet publike, a janë stimujt e investimeve konkurruese – janë çështje reale që përcaktojnë klimën e investimeve. Ne duhet të ofrojmë një mjedis tërheqës për të siguruar investitorë strategjikë. Ne duam të jemi konstruktiv, nuk duam thjesht të ankojemi, ndaj dhe kemi krijuar një vizion të quajtur Axhenda e Investimeve, e cila ka 40 rekomandime, duke përfshirë strategjinë e investimeve (sektorët prioritarë, vendndodhjet, infrastrukturën), një paketë kundër korrupsionit (e bën të lehtë që agjencitë e zbatimit të ligjit të identifikojnë dhe kapin aktet e gabuara), një reformim i plotë i Prokurimit Publik në mënyrë që të gjithë të kenë akses, zbatim i Konsultimit Publik në mënyrë që të rrisë besimin dhe angazhimin e grupeve të interesit dhe në fund një sistem tatimor modern që është konkurrues në rajoni, lufton informalitetin dhe pasqyron standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. Kjo nuk është lista jonë e dëshirave është përbërësi bazë i një ekonomie të suksesshme dhe konkurruese dhe së bashku me Dhomën Amerikane, ky është një vizion që ne ndajmë me dhomën gjermane, franceze dhe italiane”, tha ai. Po ashtu, Presidenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë, Enio Jaço tha se, “Dua të vë në dukje 2 mundësi të rëndësishme për ekonominë shqiptare dhe komunitetin e biznesit të Dhomës Amerikane. E para është teknologjia. Tani keni një shans për të hapur një biznes në Shqipëri dhe për të pasur një klient në SHBA. Kjo është një mundësi e vërtetë dhe disa duke përfshirë anëtarët tanë po e bëjnë, por për ta bërë atë në masë, sigurisht që ju duhet një mjedis më konkurrues. Së dyti është procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian, i cila është në pragun tonë dhe paraqet njëkohësisht një sfidë dhe një mundësi të pabesueshme. Bizneset duhet të rrisin standardet për të qenë në gjendje të jenë konkurruese në tregjet e BE-së, por ata gjithashtu mund të hyjnë në tregjet e BE-së tani. Dhe për të përfituar si nga teknologjia ashtu edhe nga tregjet e BE-së, ne kemi nevojë për një kuadër më konkurrues biznesi dhe investimesh. Megjithatë, kjo kërkon një partneritet të vërtetë midis sektorit publik dhe privat – asnjë vend i suksesshëm dhe i zhvilluar nuk e ka arritur këtë i vetëm. Shpresojmë të shohim një bashkëpunim të përmirësuar në vitet e ardhshme”, tha në fund Presidenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë, Enio Jaço në Asamblenë e Përgjithshme e cila u zhvillua në datën 24 Prill 2023. Ky është eventi më i rëndësishëm që Dhoma organizon çdo vit. Me këtë rast, AmCham ka kënaqësinë dhe ka mundur të ftojë të marrin pjesë në sponsorizimin e Asamblesë dhe të njihen me mundësitë promovuese si dhe përfitimet për kompaninë mbështetëse për këtë event.

Menjëherë pas mbylljes së eventit të zhvilluar, Dhoma Amerikane përmes një postimi në rrjetet sociale falenderoi në mënyrë të veçantë sponsorat e Asamblesë së Përgjithshme, të cilët me bujarinë e tyre na ndihmuan të zhvillojmë një event cilësor.



**“Gjatë dy viteve të fundit,
investimet janë rritur në 220
milionë dollarë – një rritje e
jashtëzakonshme prej 250%.”**

**-Enio Jaço,
Presidenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë**

Albsig, me Treguesit Financiar më të Mirë në Total Sipas Portofoleve dhe me Raportin e Vullnetareve më të Larta në Treg me 66.40%

Tregu i sigurimeve po rritet me ritme dyshifrore në muajt e parë të vitit 2023. Sipas statistikave nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), për periudhën Janar-Mars primet e shkruara bruto në sigurime janë rritur me 19.31% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për muajin Janar-Mars 2023 kapën vlerën 5,142 milionë lekë, ose 20.12% më shumë se në Janar-Mars 2022. Gjatë muajit Janar-Mars 2023, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 285,282 me një rritje prej 15.23% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.88% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, sigurimet e Jetës kanë 8.09% dhe risigurimi 0.028%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të Sigurimit Vullnetar zenë 46.58% dhe primet e shkruara bruto të Sigurimit të Detyrueshëm zenë 53.42% të totalit të tregut. Referuar këtyre statistikave për muajt Janar-Mars 2023 Shoqëria e Sigurimeve Albsig pjesë e Kastrati Grup, renditet në vendin e dytë me 23.25% të tregut, duke patur rritje më të madhe me veten me 36.30%, ndërkohë që siç e thamë dhe më lart tregu në total është rritur me 19.31%.

46.58%

**Sigurimi
Vullnetar**

53.52%

**Sigurimi i
Detyrueshëm**



Sigurimi i Pronës, një Mundësi për t'u Mbrojtur nga të Papriturat

Sigurimi i pronës është një nga konceptet e reja që ka hyrë në marrëdhëniet financiare të qytetarëve me pronën e tyre. Një ndër mundësitë që ofron tregu i sigurimeve është edhe mbrojtja nga ngjarjet e vështira natyrore, të cilat mund të sjellin pasoja edhe në pronën e qytetarëve apo bizneseve. Kjo, në shumicën e rasteve, është e lidhur edhe me detyrimet e kërkuara nga marrëdhëniet me bankat, për kreditë që merren nga qytetarët për blerjen e banesave apo zhvillimin e aktiviteteve të bizneseve që ata disponojnë. Bazuar në buletin statistikor të AMF, treguesit financiar më domethënës për konsumatorët duket se i ka Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Grup. Konkretisht në Sigurimin Vullnetar, sipas AMF për periudhën Janar-Mars 2023, Albsig ka raportin më të lartë në treg prej 66.40%. Njëkohësisht theksojmë se Albsig renditet në vend të parë për Përgjegjësinë e Ndërtuesit duke zënë 46.03% të tregut për muajt Janar-Mars 2023. Ndër produktet e pronës veçohet ajo e Sigurimit nga Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtimet e tjera në Pronë ku për muajt Janar-Mars 2023 renditet në vendin e dytë duke zënë 31.67% të tregut. Ndërkaq, po për periudhën Janar-Mars 2023 ndarja e tregut për Sigurimin e Aksidenteve dhe Shëndetit, Albsig renditet në vend të dytë me 32.30% dhe ka rritje me veten me 24.58%. Përsa i përket ndarjes së tregut për sigurimet nga sëmundjet sërish Albsig zë vendin e dytë me 36.59% dhe me rritje 29.95% ndërkohë që vetë tregu në total ka ulje. Njëkohësisht nuk duhet harruar dhe për Përgjegjësitë Civile, Albsig për muajt Janar-Mars 2023 zë vendin e parë me 52.14% të tregut duke u pasuar serish me vendin e parë në Sigurimin e Garancive, ku për muajt Janar-Mars zë 42.25% të tregut. Për një periudhë relativisht të gjatë, Albsig është lider në tregun e sigurimeve në Shqipëri për Sigurimin KASKO edhe për muajt Janar-Mars 2023 duke zënë 37.53% të tregut. Albsig del në pah dhe cilësohet nga statistikat e buletinit të AMF si shoqëria lider, me numrin më të vogël të dëmeve të papaguara në Mars 2023. Krahasuar edhe me të njejtën periudhë të një viti më parë, ka një rënie në vlerë me 16.04%, çfarë evidenton që Albsig paguan në kohë rekord të gjitha llojet e dëmeve!

JANAR-MARS 2023

VENDI I PARË

66.40%

RAPORTI MË I LARTË
NË TREG PËR
SIGURIMET VULLNETARE

JANAR-MARS 2023

VENDI I PARË

16.04%

LIDER PËR
REDUKTIMIN
E DËMEVE TË
PAPAGUARA

JANAR-MARS 2023

VENDI I PARË

46.03%

RAPORTI NË TREG
PËR PËRGJEGJËSINË
E NDËRTUESIT

JANAR-MARS 2023

VENDI I PARË

37.53%

RAPORTI
NË TREG PËR
SIGURIMIN
KASKO

JANAR-MARS 2023

VENDI I DYTË

32.30%

RAPORTI NË TREG PËR
SIGURIMIN E AKSIDENTEVE
DHE SHËNDETIT

JANAR-MARS 2023

VENDI I DYTË

31.67%

RAPORTI NË TREG PËR
SIGURIMIN NDAJ ZJARRIT,
FORCAVE TË NATYRËS &
DËMTIMET E TJERA NË PRONË

JANAR-MARS 2023

VENDI I PARË

52.14%

RAPORTI
NË TREG PËR
PËRGJEGJËSINË
CIVILE

JANAR-MARS 2023

VENDI I PARË

42.25%

RAPORTI
NË TREG
PËR
GARANCITË



ALBSIG



PJESË E
KASTRATI GROUP

Vera po Fillon?! Si të Blejmë Online Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim në Albsig



Vera po afron dhe gjithësecili prej nesh ka nisur prenotimet e pushimeve brenda dhe jashtë vendit. Zbuloni pse Sigurimi i Shëndetit në Udhëtim është i domosdoshmi për ju dhe familjen tuaj. Organizimi i udhëtimeve jashtë vendit është ende i paparashikueshëm për shumë familje në vendin tonë. Edhe pse mentaliteti dhe mungesa e kulturës mbi sigurimet tek ne luan një rol shumë të rëndësishëm, serish në vendin tonë duket se ka shumë probleme në këtë fushë. Por situata sa vjen e ndryshon në Evropë dhe SHBA. Çdo udhëtim përmban një sasi të caktuar pasigurie, kjo është arsyeja pse ekziston mundësia e Sigurimit të Shëndetit në Udhëtim. Blerja e kësaj police mund të konsiderohet një pjesë standarde e përgatitjes së udhëtimit. Procedurat janë tej mase lehtësuese. Çmimet në Albsig janë shumë konkurruese. Shërbimi i platformës online është nga më cilësorët në Albsig. Mjafton të navigosh në web-faqen zyrtare të Shoqërisë Albsig dhe të shkosh te seksioni “Bli Online”. Më pas të shkoni tek Shëndeti në Udhëtim dhe me pak procedura shumë të thjeshta por të domosdoshme ju mund të pajiseni online me Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim. “Me 8€ Sigurim Shëndeti në Udhëtim, kam mundur të përfitoj dëmshpërblimin sepse kisha një dëm me vajzën e vogël në pishinë”, tregon Migena Metani kliente në Albsig. Ajo shton se kultura mbi sigurimet duhet shtuar e në shumë raste duhet inductuar sidomos tek të rinjtë. Kudo që të vendosni të udhëtoni në botë, nga Gjermania, Italia, Azia në SHBA, Sigurimi i Shëndetit në Udhëtim e mbulon të gjithë botën, pra çdo gjë jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë. Problemet e mundshme që dalin kur udhëtoni jashtë vendit janë shpesh më të ndërlikuara për t'u zgjidhur. Udhëtimi jashtë vendit është një përvojë emocionuese, por mund të ndodhin sëmundje dhe aksidente të paparashikueshme. Faturat mjekësore që rezultojnë nga kjo mund të jenë dërrmuese. Sigurimi mjekësor i udhëtimit ju mbron në rast sëmundjeje ose aksidenti kur udhëtoni jashtë vendit. Ai ofron përfitimet kryesore mjekësore apo të riatdhesimit në rast urgjence, cilido destinacioni juaj.

ÇFARË PËRFSHIN



- Vizita mjekësore urgjente
- Shpenzimet për medikamentet mjekësore
- Trajtime spitalore urgjente
- Riatdhesim

DËMET E MBULUARA

- Sëmundje akute
- Aksidentet
- Humbja e jetës

Për të gjitha pyetjet tuaja, agjentët tanë janë në dispozicionin tuaj me e-mail ose bisedë në web-chat internet në këndin e poshtëm djathtas të kësaj faqe që po lexoni aktualisht. Ekziston edhe një nr. telefoni +355 68 20 52 744 dhe na ndiqni në faqen tonë në Facebook apo në Instagram.

Bli Online





☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL